



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKE RUSKË  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

09.08.2022

Titulli / Naziv / Ime	09.08.2022	Titulli / Naziv / Ime	Titulli / Naziv / Ime
Nr. i Dokumentit / Dokument No.		Shprehja / Prilog	Vlera / Vrednost

01-016/01-841



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 36, paragrafi 2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më datën 09.08.2022, miraton këtë:

## DEKLARATË

I. Konfirmojmë qëndrimin tonë si këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, të zgjedhur nga ana e qytetarëve se Sh.f.m.u.l” Halil Alidema “në Pozharan duhet të përfundoj punimet sa më parë në mënyrë që nxënësve të ju krijoj hapësirë të mjaftueshme për mesimnxënje dhe aktivitete tjera mësimore dhe personeli arsimor kushte dhe hapësirë të mjaftueshme për ushtrimin e profesionit të shenjtë të tyre për mësimdhënie.

II. Njëashtu edhe mënjanimi i projektit të çerdhës së re në Viti, që është domosdoshmëri për qytetarët tonë të kthehet si projekt i ndarë më parë dhe të fillojnë procedurat e ri tenderimit.

III. Kjo neglizhencë dhe mos efikasitet nga fillimi e deri më tani i përfundimit të punimeve shpreh shqetësimin e përfaqësuesve të institucioneve lokale, si përfaqësues të qytetarëve të Vitisë. **Andaj** në përfaqësuesit e institucioneve lokale në emër të gjithë qytetarëve të komunës sonë, nëpërmjet kësaj deklaratë drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë kërkojmë që të adresohet kërkesa dhe nëvoja e nxënësve dhe prindërve të komunës së Vitisë për përfundimin sa më parë të Sh.f.m.u.l” Halil Alidema “ në Pozharan dhe fillimin e ndërimit të çerdhës së re në Viti.

IV. Nisur nga arsyeshmëria e kërkesës dhe nevojës urgjente të qytetarëve, Kuvendi Komunal i Komunës së Vitisë, miraton këtë deklaratë, përmes të cilës **KËRKON**, që Qeveria e Republikës së Kosovës, t’i shfrytëzoj mundësitë ligjore urgjente në përfundimin dhe realizimin e këtyre projekteve jetike për arsimin në Viti.

KRYESUES I KUVENDIT

Bekim Azizi

Ali Bajrami Shef i GP të LDK-së

Jakup Demiri GP të LVV-së

Taulant Haxhiu Shef i GP të PDK-së

Reshat Azizi Përfaqësues i AAK-së

Viti, më: 09.08.2022